



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 pika 10, neni 22, neni 23 paragrafi 1 dhe neni 82 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019), neni 40 dhe Neni 41 i Rregullores së Punës të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) në seancën e 50 -të të KSHPK -së të mbajtur më 21.07.2021 morri,

## VENDIM

Procedura në numrin 08-3870 nga viti 2020, për shkelje të dispozitave të nenit 82 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nga personi \_\_\_\_\_, ish-zëvendësministër për \_\_\_\_\_ në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë Veriore, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm sipas lëndës me numër 08-3870/1 të datës 11.11.2020.

Lënda me numër 08-3870/1 datës 11.11.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Lënda me numër 08-3870 / 1 të datës 11.11.2020 është formuar me vet - iniciativë. KSHPK -ja, pas inspektimit të regjistrave të saj, konstatoi se personi \_\_\_\_\_ më 03.01.2020 pushoi së mbajturi postin e zëvendësministrit për \_\_\_\_\_ në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe se brenda afatit të përcaktuar me ligj pas përfundimit të funksionit të caktuar nuk kadorëzuar listë anketuese në KSHPK.

Në të njëjtën ditë, personi \_\_\_\_\_ u zgjodh në pozitën e zëvendësministrit për \_\_\_\_\_ në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe se brenda afatit të përcaktuar me ligj nuk dorëzoi listë anketuese dhe deklaratë interesash në KSHPK.

Bazuar në sa më sipër, KSHPK i lëshoi personit \_\_\_\_\_ një urdhërpagesë kundërvajtëse me numër 08-3870 / 3 të datës 13.11.2020 për kundërvajtje të caktuar me nenin 82 paragrafi 3 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, i dënueshëm sipas Nenit 109 të të njëjtit ligj si dhe urdhërpagesa kundërvajtëse numër 08-3870 / 5 nga 13.11.2020 për kundërvajtje sipas nenit 82 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, i dënueshëm sipas nenit 109 të të njëjtit ligj.

Nga ana e të emruarit është vepruar sipas urdhërpagesës kundërvajtëse, gjegjësisht është paguar gjysma e gjobës së përcaktuar me të njëjtën.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: A.Ç., udhëheqës i njësisë  
Miratoi: SH:S, anëtar i KSHPK - së

KOMISIONI SHITETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
Kryetar,  
Biljana Ivanovska